

“INFO TELECOM” SHPK
PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023



Tiranë më 20 Mars 2024

PËRMBAJTJA

- Pasqyrat Financiare dhe Shënimet

I.- Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor	4
II.- Pasqyra e Fitim (Humbje)dhe te Ardhurave Gjitheperfshirëse 31 Dhjetor 2023	5
III.- Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023	6
IV.- Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.....	7
V.- Shënime Mbi Pasqyrat Financiare	8
1- Informacion i pergjithshem	8
2.- Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF).....	9
2.1- Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale	9
2.2- Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara	9
3.- Bazat e përgatitjes së pasqyrave Financiare.....	10
3,1.- Deklarata e pajtueshmërisë	10
3,2.-Biznesi në vijimësi	10
3,3.-Krahasueshmëria.....	10
3,4.-Monedha funksionale dhe e paraqitjes	10
3,5.-Vlerësime dhe gjykime	10
4.-Politikat Kontabël	11
4.1 Transaksionet në monedhë të huaj.....	11
4.2 - Instrumentat financiarë.....	12
4.3 -Inventarët.....	13
4.4 -Aktive afatgjata materiale	13
4.5-Aktivet afatgjatë jo-materiale.....	14
4.6-Aktivet jo-financiare	15
4.7-Kosto e huamarrjes	15
4.8-Të ardhurat.....	15
4.9-Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit.....	15
4.10 -Qirate.....	15
4.11-Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	16
4.12-Tatimi mbi fitimin.....	16
4.13-Përfitimet e punonjësve.....	16
4.14-Transaksionet me palët e lidhura	16
4.15-Provizionet	16
4.16-Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara.....	17
5 -Aktivet Afatgjata.....	18
5.1-Aktivet Afatgjata Materiale	18
5.2-Investime ne pjesemarrje	19
5.3-Aktivet Afatgjata JoMateriale.....	19
6 Aktivet Afatshkurtra.....	20
6.1-Inventare	20
6.2-Llogari te arketueshme Tregtare	20
6.3-Llogari te arketueshme e Te Tjera Te arketueshme	21
6.4-Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e tyre.....	22

6.5-Te ardhura te llogaritura.....	22
7 - Per Kapitale e veta.....	22
8. - Detyrimet afatgjata.....	23
9. - Detyrimet Afatshkurtra.....	24
10. -Të ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit.....	25
11. - Shpenzime te Shfrytezimit.....	26
12. – Te ardhura dhe shpenzime financiare.....	28
13. – Rezultati Financiar.....	29
14 - Manaxhimi i riskut financiar.....	30
15- Transaksionet me palët e lidhura	30
16- Vlera e drejtë e instrumentave financiare	30
17- Ngjarje pas datës së raportimit financiar	30

Pasqyrat Financiare INFO TELECOM SHPK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

.....(Vlerat në lekë).....

I.- Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2023

L- Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 Dhjetor 2023					
Nr	Përshkrimi	Shënime	Mbyllur më	Mbyllur më	Mbyllur më
			31-12-2023	31-12-2022	31-12-2021
AKTIVET					
Aktivet Afatgjata					
1	Aktivitet afatgjata materiale		1 093 986 435	840 893 933	809 438 497
2	Investime & huadhenie ne pjesemarrje		28 770 000	23 970 000	124 295
3	Aktive afatgjata jomateriale		4 448 497	2 716 908	1 544 075
Total Aktive Afatgjata			1 127 204 932	867 580 841	811 106 867
Aktivet afatshkurtra					
1	Inventarë		180 290 594	171 326 546	131 307 430
2	Llogari të arkëtueshme tregtare		745 332 366	1 926 366 969	2 287 695 402
3	Llogari të arkëtueshme të tjera		1 502 198 278	651 438 783	521 966 171
4	Te ardhura te llogaritura		27 276 064	425 916 671	
5	Mjete monetare në arkë dhe bankë		549 709 732	399 007 626	1 660 181 993
Total Aktive Afatshkurtra			3 004 807 034	4 835 230 962	3 339 976 629
Totali i Aktiveve			4 132 011 966	5 702 811 803	4 151 083 496
KAPITALI DHE DETYRIMET					
1	Kapitali aksionar		1 200 000 000	1 200 000 000	20 000 000
2	Rezerva ligjore		120 000 000	102 810 490	24 338 394
3	Rezerva të tjera		269 731 186		608 403 037
4	Fitime/humbje të ushtrimit		393 618 545	1 046 920 696	650 069 059
Totali i kapitalit			1 983 349 731	2 349 731 186	1 302 810 490
DETYRIMET					
Detyrimet afatgjata					
1	Hua afatgjata		341 335 940	414 839 845	489 999 494
2	Grante Të ardhura të shtyra etj				
Totali I detyrimeve afatgjata			341 335 940	414 839 845	489 999 494
Detyrime afatshkurtra					
1	Hua afatshkurtra		901 253 355	629 113 212	433 459 214
2	Llogari të pagueshme (furnitorë)		862 946 002	1 709 589 652	1 862 617 117
3	Detyrime tatimore		360 198	85 079 571	59 527 942
4	Llogari të pagueshme të tjera		4 169 606	2 431 993	2 294 883
5	Parapagime		999 765	354 113	374 356
6	Shpenzime te llogaritura		37 597 370	511 672 229	
Totali Detyrime afatshkurtra			1 807 326 295	2 938 240 771	2 358 273 512
Totali i Detyrimeve			2 148 662 235	3 353 080 616	2 848 273 006
Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve			4 132 011 966	5 702 811 803	4 151 083 496

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator i INFO TELECOM Shpk

ADA OSMANAJ

Ada Osmana



Hartues i pasqyrave financiare

MIMOZA KORBECI

ELONA MUCA

Pasqyrat Financiare INFO TELECOM SHPK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

.....(Vlerat në lekë).....

II.- Pasqyra e Fitim (Humbje)dhe te Ardhurave Gjitheperfshirëse 31 Dhjetor 2023

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
TË ARDHURAT				
1	Të ardhura nga shitja	18 006 925 318	28 376 560 830	20 144 768 907
2	Të ardhura të tjera	71 934 539	67 718 879	27 889 287
3	Autofaturime	16 515 099 300	17 656 029 029	16 322 152 254
	Totali	34 593 959 157	46 100 308 238	36 494 810 448
SHPENZIMET				
1	Materiale të konsumueshme	(17 192 726 791)	(26 889 506 069)	(19 197 761 789)
2	Kosto e punës	(123 675 820 000)	(95 692 054)	(85 914 013)
3	Zhvlerësimi dhe amortizimi	(53 992 075)	(47 001 157)	(21 946 802)
4	Shpenzime të tjera	(126 873 850)	(95 052 048)	(71 605 379)
4	Autofaturime	(16 515 099 300)	(17 656 029 029)	(16 322 152 254)
	Totali	(34 012 368 836)	(44 783 280 357)	(35 699 380 237)
	Fitimi operativ	581 591 321	1 317 027 881	795 430 211
Të ardhura/shpenzime financiare				
1	Interesa Neto	(31 891 492)	(53 969 368)	(19 238 221)
2	Këmbimi valutor neto	(85 828 636)	(31 204 039)	(11 210 865)
3	Te Tjera			
	Totali	(117 720 128)	(85 173 407)	(30 449 086)
	Fitimi para tatimit	463 871 193	1 231 854 475	764 981 125
1	Tatimi i shtyrë			
2	Shpenzim Tatim Fitimi	(70 252 648)	(184 933 779)	(114 912 066)
	Fitimi Neto	393 618 545	1 046 920 696	650 069 059
1	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
2	Fitimi nga kompani mëmë			
	Totali i të ardhurave gjithë përfshirëse	393 618 545	1 046 920 696	650 069 059

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator i INFO TELECOM Shpk

ADA OSMANAJ

(Ada Osmanaj)

(Signature)



Hartues i pasqyrave financiare

MIMOZA KORBECI

ELONA MUÇA

(Signature)

Pasqyrat Financiare INFO TELECOM SHPK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

.....(Vlerat në lekë).....

()

III.- Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim/humbja e vitit financiar	Totali
Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2021	20 000 000	24 338 394	608 403 037		652 741 431
Transaksionet me pronarët					
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2021				650 069 059	650 069 059
Pozicioni me 31 Dhjetor 2021	20 000 000	24 338 394	608 403 037	650 069 059	1 302 810 490
Miratimi i rezultatit 31.12.2021	1 180 000 000	78 472 096	(608 403 037)	(650 069 059)	
Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2022	1 200 000 000	102 810 490	0		1 302 810 490
Transaksionet me pronarët					
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2022				1 046 920 696	
Pozicioni me 31 Dhjetor 2022	1 200 000 000	102 810 490	0	1 046 920 696	2 349 731 186
Miratimi i rezultatit 31.12.2022	0	17 189 510	269 731 186	(286 920 696)	
Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2023	1 200 000 000	120 000 000	269 731 186	760 000 000	2 349 731 186
Transaksionet me pronarët -dividente te shperndare				-760 000 000	
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2023				393 618 545	
Pozicioni me 31 Dhjetor 2023	1 200 000 000	120 000 000	269 731 186	393 618 545	1 983 349 731

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator i INFO TELECOM Shpk

ADA OSMANAJ

(Ada Osmaj)



Hartues i pasqyrave financiare

MIMOZA KORBECI

(Mimoza Korbeci)
ELONA MUÇA

(Elona Muça)

Pasqyrat Financiare INFO TELECOM SHPK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

.....(Vlerat në lekë).....

IV.- Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
1	Fitimi para tatimit	463 871 193	1 231 854 475	764 981 125
	Rregullime për			
1	Amortizimi	53 992 075	47 001 157	21 946 802
2	Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme			
3	Efekte nga kursi i këmbimit	85 828 636	31 204 039	11 210 865
4	Efekte nga tatimi i fitimit	(70 252 648)	(184 933 958)	(114 912 066)
5	Rritje/Renie Të ardhura te llogaritura	(398 640 607)	(425 916 671)	
6	Rritje/Renie Shpenzime te llogaritura	(474 074 859)	511 672 229	
	Lëvizjet e Kapitali qarkullues			
8	Rritje(-), rënie(+) teprica e kërkesave për arkëtim	330 275 108	231 855 821	(1 427 960 133)
9	Rritje(-), rënie(+) teprica e inventarit	(8 964 048)	(40 019 117)	(131 307 430)
10	Rritje(-), rënie(+) teprica e furnitorëve	(846 643 650)	(153 027 465)	761 119 394
11	Rritje(-), rënie(+) teprica e llog. tjera të pagueshme	1 737 613	137 111	475 623
12	Rritje(-), rënie(+) në marrëdhëniet me buxhetin	(84 719 373)	25 551 629	56 733 818
13	Rritje(-), rënie(+) në parapagime	645 651	(20 243)	374 356
	Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit	(149 663 695)	1 275 359 186	(53 337 645)
	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
1	Arktetime/Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale & jomateriale	(309 250 704)	(83 464 249)	(810 312 651)
3	Rivlerësimi i aseteve			
4	Te ardhura nga shitja e pajisjeve	434 536	3 834 824	
6	Pjesëmarrje ne investime & Huadhenie afatgjata	(4 800 000)	(23 845 705)	(124 295)
	Mjete monetare neto nga aktivitetet investuese	(313,616,168)	(103 475 130)	(810 436 946)
	Fluksi monetar nga veprimtari te financimit			
1	Hua të arkëtuara /paguara (Neto)	199 574 118	121 394 148	770 123 375
2	Dividente te shperndare	(760 000 000)		
3	Te tjera te pagueshme afatgjata	(937 880)	(899 799)	3 940 494
	Mjete monetare neto nga aktivitetet financiare	(561 363 762)	(120 494 349)	774 063 869
	Rritja (+) Rënia (-) neto e mjeteve monetare	(1 024 643 625)	1 292 378 406	(93 710 722)
	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	1 660 181 993	399 007 626	503 929 213
	Efekt i kurseve te kembimit	(85 828 636)	(31 204 039)	(11 210 865)
	Mjete monetare në fund të periudhës kontabile	549 709 732	1 660 181 993	399 007 626

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator i INFO TELECOM Shpk

ADA OSMANAJ

(Ada Osmana)



Hartues i pasqyrave financiare

MIMOZA KORBECI

ELONA MUÇA

V.- Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1- Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "INFO TELECOM " SHPK është themeluar ne date 24.11.2009 dhe është regjistruar në QKB më datën 02.12.2009.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rr.Faik Konica Nr.1, Pallati i Kuq, Tirane

NIPT-i i Shoqërisë është K92402002P

Përfaqesuesi ligjor i i shoqërisë është Zj. ADA OSMANAJ

Objekti i veprimtarise se kësaj shoqërie është ofrimi i shërbimeve dhe çdo aktivitet ne fushen e telekomunikacionit te percaktuara ne legjislacionin perkates shqiptar; perfaqesimi i shoqerive te ndryshme te huaja ne territorin shqiptar; perfshirja dhe ofrimi i perzgjedhjeve per tendera apo kompani me natyre telekomunikacioni, shkollime per te interesuarit me ose pa eksperience ne fushen e teknologjise se avancuar; Aktivitete import eksporti te makinerive e pajisjeve te fushes se telekomunikacionit; Import-eksport per mallra te ndryshme etj; Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime hidro, gaz natyror, qymyr si dhe nga burime alternative si parqet e erez, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasat etj; Aktivitete ne blerjen, shitjen, qiradhenien e zyrove, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme; Çdo aktivitet tjeter te lejuar nga ligji.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet me Ligjin Nr.79901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Kapitali i Regjistruar i shoqerise me 31.12.2023 është 1,200,000,000 lekë i perbere nga 1 kuotë dhe zotërohet tërësisht nga Ortaku i Vetëm shoqeria Gjonaj Group Holdings SHPK me **NIPT: M22010013H**

Numëri i të punësuarve më 31.12.2023 është 75 punonjes, nga 47 punonjës që ishin në vitin 2022

Drejtimi i shoqerise realizohet nga **Zj. ADA OSMANAJ**, Administratore.



2.- Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1- Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 "Pasqyra e Levizjes së Parasë"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara (efektive per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2018)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje per të eliminuar mospërputhjet dhe per të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2019)

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2- Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e publikimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"**,
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme,
- **SNRF 16 "Qiratë"**,
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** ,
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme,
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata te investuara
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve"**
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2019)"**
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"**
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"**

Shoqëria ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur në këtë shoqëri filloi zbatimi i SNRF (01.01.2019). Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3.- Bazat e përgatitjes së pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht.0 Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

3.1.- Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2.-Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.3.-Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar.

3.4.-Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5.-Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimit të shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen

vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për

të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3.5.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjëndjet e inventarit në qarkullim të ulët dhe në inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rastet ku vlera neto e realizueshme është më e ulët se vlera kontabël neto , ekziston një tregues që inventari është zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj (çmuarjen)për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

4.-Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31.12.2023 dhe më 31.12.2022 është detajuar si më poshtë:

	31.12.2023	31.12.2022
- EURO/LEK.....	103.88	114.23
- USD/LEK.....	93.94	107.05

4.2 - Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit..

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për llogaritë e pagueshme, të papaguara dhe të pakërkua për më shumë se pesë vjet, për të cilat shoqëria, bazuar në të dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmësi për shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e mësipërme nuk duhen njohur si të tilla por i njeh si të ardhura të vitit kur bëhet fshirja e tyre.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivitet financiar të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese.

Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve

4.3 -Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me metoden e koston mesatare. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur koston e tyre historike dhe përfshirjen e të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike dhe janë inventarizuar në datën 31.12.2021.

4.4 -Aktive afatgjata materiale

a.-Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Programi iblerë që është pjesë përbërëse në funksion të një paisjeje është kontabilizuar si pjesë e paisjes

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

b.-Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

c.-Amortizimi

Amortizimi i aktiveve Afatgjatë Materiale (AAM) llogaritet **mbi vleften e mbetur** sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimi
-.Toka	*	*
-Ndërtesa	Vlefta e mbetur	5 %
-Makineri dhe Pajisje	Vlefta e mbetur	20 %
-Mjete transporti	Vlefta e mbetur	20 %
-. Pajisje zyre	Vlefta e mbetur	20 %
-.Paisje informatike	Vlefta e mbetur	25 %

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat që tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë kur vlera kontabile tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar, aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim. Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

ç.-Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5-Aktivet afatgjatë jo-materiale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse :

Është e mundshme që përfitime e pritshme ekonomike në të ardhmen të cilat i atribuohen atij aktivit do të rrjedhin tek njësia ekonomike, dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmeri.

Njësia ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqsojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Aktivet afatgjatë jo-materiale njihen fillimisht me Koston me koston historike të tyre. Mbas njohjes fillestare një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Amortizimi i aktive jo-materiale llogaritet në mënyrë lineare me 15 % mbi koston historike

4.6-Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohej me një normë skontimi para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

4.7- Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjmë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.8- Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.9-Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.10-Qirate

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve në termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njohen në të ardhura ose në shpenzime në mënyrën lineare gjatë afatit të gjatë.

Shoqëria ka vetëm qira operative



4.11-Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.12-Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2023 është 15%

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka tatim fitimi të shtyrë.

4.13-Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

-Shoqëria nuk ka kontrata kolektive me punonjesit

4.14-Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.15-Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për

5 -Aktivet Afatgjata

5.1-Aktivet Afatgjata Materiale

Pasqyra e lëvizjes së AAM paraqitet si vijon:

Për Instalime ne Ndertese, Makineri e paisje, Mjetet e transportit, Pajisje Informatike, Pajisje zyre amortizimi llogaritet sipas normave fiskale.

	Ndertesa & Instalime ne Ndertese	Makineri dhe Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje Informatike	Pajisje zyre	Total
Vlera Bruto a AAM me 31 dhjetor 2022	824 290 878	14 828 699	36 112 924	18 524 422	35 168 220	928 925 142
Shtesa gjate 2023	226 620 293			1 201 329	79 250 418	307 072 040
Pakesime gjate 2023	71 778					71 778
Vlera Bruto a AAM me 31 dhjetor 2023	1 050 839 393	14 828 699	36 112 924	19 725 751	114 418 638	1 235 925 404
Amortizimi I Akumuluar 31 Dhjetor 2022	56 407 702	7 768 600	1 488 141	13 316 954	9 049 812	88 031 210
Pakesime Amortizimi I Vitit 2023	38 467 055	1 412 020	6 924 957	1 425 509	5 678 219	53 907 759
Amortizimi I Akumuluar 31 Dhjetor 2023	94,874,757	9 180 620	8 413 098	14 742 463	14 728 031	141 938 968
Vlera Neto e AAM 2022	767 883 176	7 060 098	34 624 783	5 207 468	26 118 407	840 893 933
Vlera Neto e AAM 2023	955 964 636	5 648 078	27 699 827	4 983 288	99 690 606	1 093 986 436

Shoqëria ka investuar gjatë vitit 2023 për Ndertesa & Instalime ne Ndertese ne shumen 226,620,293 Leke , dhe ka shitur Instalime ne Ndertese – pakesimi ne vleren bruto 71,778 Leke, ka investuar ne Paisje Kompjuterike ne shumen 1,201,329 lekë, dhe ka blere Mobilje Paisje Zyre ne shumen 79,250,418 lekë,.

Gjatë vitit 2023 është llogaritur amortizimi i A.A.Materiale në shumën 53,907,759 Leke.

5.2-Investime ne pjesemarrje& Huadhenie Afatgjata

Në bilanc, më 31.12.2023 ne zerin Aktive Aktive Afatgjata Financiare ne shumen 28,770,000 Lek shoqëria ka raportuar Investime ne pjesemarrje ne shumen 27,970,000 Lek, nga 23,770,000 Lek qe ishin nme 31.12.2022 jane rritur ne shumen 4,000,000 Leke si kontribute per zmadhimin e kapitalit tek shoqeria AMB Construction dhe 800,000 Lek huadhenie tek shoqeria Info-Telecom Albsolar 2.

5.3-Aktivet Afatgjata JoMateriale

Në bilanc, më 31.12.2023 shoqëria ka raportuar Aktive Afatgjata Jomateriale me vlefte neto 4 448 496 Leke

	Në lekë		
	Patenta Licenca	Studime Projekte	Total
Vlera Bruto a AAJM me 31 dhjetor 2022	789 874	2 289 972	3 079 846
Shtesa gjate 2023 Pakesime	106 964	2 071 700 362 760	2 071 700 362 760
Vlera Bruto a AAJM me 31 dhjetor 2022	896 838	3 998 912	4 895 750
Amortizimi i Akumuluar 31 Dhjetor 2022	362 939		362 939
Pakesime Amortizimi i Vitit 2023	84 316		84 316
Amortizimi i Akumuluar 31 Dhjetor 2023	447 254		447 254
Vlera Neto e AAM 2022	426 936	3 998 912	2 716 908
Vlera Neto e AAM 2023	449 584	3 998 912	4 448 496

Konçensione, patenta, marka e të ngjajshme; Janë blerë gjatë vitit 106,964 Lekë licenca windows te cilat amortizimi i llogaritur ne shumen 84,316 Leke.

Studime Projekte; Jane blere gjate vitit 2023 ne shumen 2,071,700 Leke, jane pakesuar ne shumen 362,760 Leke dhe nuk eshte llogaritur amortizim.

Gjatë vitit 2023 është llogaritur **amortizimi i A.A.Jo Materiale** në shumën 84 ,316 lekë.

Paksimi i tyre është rrjedhojë e amortizimit të llogaritur sipas SNRF, në mënyrë lineare.

Shuma Totale e Amortizimit te Aktiveve ne Bilancin e vitit 2023 eshte 53,992,075 Leke;

Per Aktive Afatgjata Materiale ne shumen 53,907,759 Leke

Per Aktive Afatgjata Jomateriale ne shumen 84,316 Leke.

6 Aktivet Afatshkurtra

Në pasqyrën e Pozicionit Financiar për ushtrimin e mbyllur më datë 31.12.2023, shoqëria ka deklaruar këto aktive afatshkurtra.

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31- 12-2023	Mbyllur më 31- 12-2022	Mbyllur më 31- 12-2021
1	Inventarë	180 290 594	171 326 547	131 307 430
2	Llogari të arkëtueshme tregtare	745 332 366	1 926 366 969	2 287 695 402
3	Llogari të arkëtueshme të tjera	1 502 198 279	651 438 783	521 966 171
4	Mjete monetare në arkë dhe bankë	549 709 732	1 660 181 993	399 007 626
5	Te ardhura te llogaritura	27 276 064	425 916 671	
	Totali	3 004 807 035	4 835 230 962	3 339 976 629

6.1-Inventare

Shoqëria ka deklaruar gjëndje inventarësh më 31.12.2023 ne shumen 180 290 594 Lek te cilat jane pajisje elektronike ne shumen 174 786 987 Leke sipas Inventarit analitik bashkengjitur ketyre shenimeve dhe punime ne proces ne shumen 5,503,607 Leke.

6.2-Llogari te arketueshme Tregtare

Llogaritë e Arkëtueshme Tregtare përbëhen nga të drejtat e arketueshme ndaj Klienteve të cilat më datën 31.12.2023 janë 745,332,366 lekë,nga te cilet 11,087,265 Leke jane *Kliente per aktivitetin e Energjise*

6.3-Llogari te arkëtueshme e Te Tjera Te arkëtueshme

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
3	Llogari të arkëtueshme të tjera	1 502 198 279	651 438 783	521 966 171
	Totali	1 502 198 279	651 438 783	521 966 171

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	31-12-2023	31-12-2022
1	Llogari parapagimi	146 979 739	8 384 117
2	Parapagime ne dogane	210 751	206 002
3	TVSH e zbritshme	45 286 831	70 817 384
4	Tatim Fitimi	61 758 523	
5	Të drejta te tjera te arkëtueshme	1 247 962 435	572 031 280
	Totali	1 502 198 279	651 438 783

Të Drejta të Tjera të Arkëtueshme gjëndje më 31.12.2023 në shumën 1 247 962 435 lekë përbëhen nga Debitorë të tjere.

6.4-Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e tyre

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
5	Mjete monetare në arkë dhe bankë	549 709 732	1 660 181 993	399 007 626
	Totali	549 709 732	1 660 181 993	399 007 626

Shuma 549,709,732 lekë e deklaruar më datë 31.12.2023 përfshin këto llogari :

Nr,	Emërtimi	Lekë
1	Mjete monetare ne llogarite bankare te shoqerise	539 839 914
2	Mjete monetare ne arke	1 714 854
3	Mjete monetare – garanci bankare	8 154 964
	Totali	549 709 732

6.5-Te ardhura te llogaritura

Te ardhura te llogaritura ne shumen 27,276,064 Leke jane fatura sherbimesh por qe i perkasin aktivitetit te vitit 2023 por qe jane konkretizuar dhe leshuar ne vitin 2024 .

7 - Per Kapitalet e veta

Kapitalet e veta te shoqerise te deklaruar ne bilancin date 31.12.2023 jane si vijon :

Në lekë

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023

(Vlerat në lekë)

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Kapitali aksionar	1 200 000 000	1 200 000 000	20 000 000
2	Rezerva ligjore	120 000 000	102 810 490	24 338 394
3	Rezerva të tjera	269,731,186	0	608 403 037
4	Fitime/humbje të mbartura	0	0	0
5	Fitime/humbje të ushtrimit	393,618,545	1 046 920 696	650 069 059
	Totali i kapitalit	1,983,349,731	2 349 731 186	1 302 810 490

Kapitali i Regjistruar me 31.12.2023, është 1,200,000,000 Leke.

Rezerva Ligjore nga 102,810,490 Leke që ishte me 31.12.2022 bëhet 120,000,000 Lekë në 31.12.2023

Rezervat e Tjera nga shuma 0 Leke që ishte me 31.12.2022 bëhet 269,731,186 me 31.12.2023.

Fitimi neto i ushtrimit për vitin 2023 është 393,618,545 Lekë. Fitimi i mbartur nga viti 2022 në Shumen 1,046,920,696 Lekë është kaluar në rritje të rezervës ligjore në shumen 17,189,510 Leke, Në rritje të rezervave të tjera në shumen 269,731,186 Leke dhe është shpërndarë si dividend në shumen 760,000,000 Leke.

8. - Detyrimet afatgjata

Shoqëria ka detyrime afatgjata në shumen 341,335,940 Leke si më poshtë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Detyrime ndaj Institucioneve të kredise	339 233 125	411 799 150	486 059 000
2	Te tjera të pagueshme Afatgjata	2 102 815	3 040 695	3 940 494
	Totali	341 335 940	414 839 845	489 999 494

Detyrime ndaj Institucioneve të kredise në shumen 339 233 125 është pjesa e mbetur për tu shlyer në Intesa SanPaolo Bank

Te tjera të pagueshme Afatgjata në shumen 2,102,815 Lekë është detyrim i mbetur në datën 31.12.2023 ndaj Porsche Leasing për blerje mjete transporti.

9. - Detyrimet Afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra detajohen si më poshtë vijon :

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Hua afatshkurtra	901 253 355	629 113 212	433 459 214
2	Llogari të pagueshme (furnitorë)	862 946 002	1 709 589 652	1 862 617 117
3	Detyrime tatimore	360 198	85 079 571	59 527 942
4	Llogari të pagueshme ndaj Punonjesve dhe sigurimeve	3 744 344	2 431 993	2 294 883
5	Llogari parapagimi	999 765	354 113	374 356
6	Llogari Te pagueshme te tjera	425 262		
7	Shpenzime te llogaritura per fatura te leshuara ne vitin 2024	37 597 370	511 672 229	
	Totali detyrime afatshkurtra	1 807 326 295	2 938 240 771	2 358 273 513

Huatë afatshkurtra përbëhen nga **Overdrafte** të marra nga institucionet bankare.

Te Pagueshme ndaj Furnitoreve më 31.12.2023 janë 862 946 002 lekë nga te cilet 300,185 Lek jane *Furnitore per Aktivitetin e Energjise Elektrike*

Detyrime Tatimore ne shumen 360 198 lekë janë detyrime per Tatim në Burim ne shumen 360 198 Leke i cili është shlyer në muajin pasardhës Janar 2024.

Llogari te Pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve

Shoqëria ka detyrim ndaj punonjesve më datën 31.12.2023 ne shumen 28,816 Leke ndërkohë që detyrimi ndaj

Sigurimeve shoqerore e shendetesore ne shumen 3,715,728 lekë është shlyer në muajin e parë të vitit pasardhës, pasi i përket muajit Dhjetor 2023.

Shpenzime te llogaritura ne shumen 37 597 370 Leke jane blerje sherbimesh interkoneksioni te cilat i takojne aktivitetit te vitit 2023 per te cilat jane leshuar fatura ne vitin 2024 .

10. -Të ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat nga veprimtaria kryesore të deklaruar nga shoqëria në Pasqyrën e Performancës për vitin 2023 janë si vijon :

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	18 006 925 318	28 376 560 830	2 0 144 768 907
2	Të ardhura të tjera	71 934 539	67 718 379	27 889 287
3	Autofaturime	16 515 099 300	17 656 029 029	16 322 152 254
	Totali	34 593 959 157	46 100 308 238	36 494 810 448

-Te Ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit për vitin financiar 2023 janë deklaruar 18,006,925,318 lekë. Këto të ardhura përbëhen nga :

- Te Ardhura nga **Shitja e Shërbimeve të komunikimeve elektronike** jashtë Shqipërisë (eksport) në shumën 16,561,852,073 lekë.

- Te Ardhura nga **Shitja e shërbimeve të komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë** në shumën 10,494,440 lekë

-Të ardhura nga **Shitje Malli** ne shumen 12,507,491 lekë përbëhen nga shitje pajisje elektronike.

-Të ardhura nga **Shitje Energji elektrike** ne shumen 1,422,071,314 lekë përbëhen nga te ardhura nga aktiviteti i shitblerjes se energjise elektrike.

- **Të ardhura nga shitjet e tjera** ne shumen 71,934,539 lekë përbëhen nga te ardhura nga qeraja per godinen qe shoqeria ka ne pronesi ne shumen 36,292,560 Leke, sherbime konsulence teknike & te tjera 33,431,760 lek, Sherbim skedulimi & kamatvonesave per *Aktivitetin e Energjise* 1,832,826 Lek dhe te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne shumen 377,393 Leke.

- **Te ardhura te tjera – kunderparti per blerje me autofature** në shumën 16,515,099,300 lekë janë deklaruar nga shoqëria si Të ardhura të ushtrimit (njëkohësisht edhe në Shpenzime për të njëjtën vlerë). Këto autofaturime janë të dokumentuara me fatura tatimore të lëshuara nga vetë

shoqëria për blerje shërbimesh jashtë vendit, sipas rregullave fiskale. Sipas këtyre rregullave Autofatura duhet të regjistrohet si në Librin e Blerjeve ashtu edhe në Librin e Shitjeve.

Shifra e Afarizmit për vitin 2023 është deklaruar në shumën 34,593,959,157 lekë.

11. - Shpenzime të Shfrytëzimit

Shpenzimet për **veprimtarinë kryesore** të deklaruara nga shoqëria INFO-Telecom shpk, në Pasqyrën e Performancës date 31.12.2023, rezultojnë si vijon:

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Mallra dhe shërbime të konsumuara	(17 192 726 791)	(26 889 506 069)	(19 197 761 789)
2	Autofaturime për shërbime të konsumuara	(16 515 099 300)	(17 656 029 029)	(16 322 152 254)
3	Kosto e punës	(123 675 820)	(95 692 055)	(85 914 013)
4	Zhvlerësimi dhe amortizimi	(53 992 075)	(47 001 157)	(21 946 802)
5	Shpenzime të tjera	(126 873 850)	(95 052 048)	(71 605 379)
	Totali	(34 012 367 836)	(44 783 280 357)	(35 699 380 237)

11.1 – Mallra dhe Shërbime të konsumuara në shumën 17 192 726 791 janë deklaruar si më poshtë

- **Kosto per sherbime telekomunikimi** ne shumen 15,915,846,024 Leke
- **Kosto e mallit te shitur (Pajisje elektronike)** ne shumen 12,043,855 Leke
- **Kosto e Energjise Elektrike te shitur** ne shumen 1,264,836,911 lekë

Për shërbimet e blera jashtë vendit, përveç faturave të lëshuara nga furnitorët, shoqëria ka lëshuar Autofatura per shërbime te konsumuara në çdo rast.

Ashtu si për Të Ardhurat, edhe në Shpenzimet e deklaruar në Pasqyrën e Performances Financiare të shoqërisë janë deklaruar në shumën 16,515,099,300 lekë, **Autofatura** të lëshuara për blerjet e shërbimeve te komunikimeve elektronike jashtë Republikës së Shqipërisë.

11.2 - Kosto e punës 123,675,820 lekë përbëhet nga Shpenzimet për **Pagat e Personelit** 109,940,745 lekë nga te cilat jane 5,472,943 leke paga te punonjesve per aktivitetin e energjise dhe shpenzimet për **Sigurimet Shoqerore e Shendetesore** 13,735,075 lekë nga te cilat jane 777,345 leke sigurime shoqerore dhe shendetesore te punonjesve per *Aktivitetin e Energjise*. Numri i të punësuarve në fund të vitit 2023 është 75 nga 47 persona që ishin në vitin e kaluar.

11.3 - Amortizimi i Aktiveve Afatgjata 53,992,075 lekë është llogaritur me normat dhe menytrat qe përcakton ligji fiskal " Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

11.4 - Shpenzime të tjera te shfrytezimit 126,873,850 lekë janë të klasifikuara e të analizuara si në pasqyrën që vijon:

Shpenzime te tjera te shfrytezimit

Viti 2023
LEK

Aktiviteti I energjise-Tarife vjetore rregullatore ERE	2,282,912
Aktiviteti I energjise-Webinare	5,370,000
Aktiviteti I energjise-Sherbime Outsource	3,886,590
Aktiviteti I energjise - Penalitet per mosrealizim sasie	1,944,775
Aktiviteti I energjise – Tarife per operatorët e tregut (COTEE)	68,940
Sherbim AKEP	412,236
Blerje per zyren	2,058,972
Blerje energji,uje	3,116,505
Blerje karburanti	3,115,000
Honorare	30,127,613
Qera ambienti	13,318,861
Sherbime per personelin	1,227,100
Mirembajtje dhe riparime	2,768,476
Sherbime IT	2,633,522
Sherbime marketing	4,016,320
Sherbime nga te Trete	6,223,823
Sigurime	1,372,284
Shpenzime pritje	3,110,461
Udhetim dieta	23,741,404

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
(Vlerat në lekë)

Publicitet reklama	260,144
Sherbime postare&telekomunikimi	3,257,630
Sherbime bankare	7,944,609
Shpenzime Transporti	42,874
Taksa tarifa vendore	215,625
Shpenzime te tjera korente	2,788,675
Taksa Regjistrimi	51,305
Shpenzime per blerje dhurata	1,307,916
Kosto e AAM te shitura	209,278
TOTAL	126,873,850

Për honoraret dhe pagesat e qerasesh është mbajtur tatimi në burim dhe është shlyer rregullisht sipas deklarimeve të bëra.

12. – Te ardhura dhe shpenzime financiare

Shoqëria ka deklaruar edhe të ardhura të tjera si vijon :

Në lekë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Interesa Neto	(31 891 492)	(53 969 368)	(19 238 221)
2	Këmbimi valutor neto	(85 828 636)	(31 204 039)	(11 210 865)
3	Të tjera Të ardhura (+) shpenzime(-)			
	Totali	(117 720 129)	(85 173 407)	(30 449 086)

Vlera Neto e kembimeve valutore ne shumen 85 828 636 Leke ka rezultuar negative ne rritje të shpenzimeve per shkak te efekteve te uljes se ndjeshme te kurseve te kembimit.

Interesa Neto ne shumen 31,891,492 Leke jane Interesat bankare te cilat jane te paguara nga shoqëria për overdraftet e marra ne institucionet financiare ne shumen 31,743,712 Leke, interesa kredie dhe interesa te paguara per makina te marra me leasing ne shumen 153,198 leke duke i zbritur vleren e interesave kreditore ne shumen 5,417 Leke.

13. – Rezultati Financiar

Nga analiza dhe rishikimi analitik i **Rezultatit Financiar** per 3 vitet e fundit, duke përfshirë edhe Autofaturimet kemi këto të dhëna :

Lekë

Nr	Përshkrimi	Mbyllur më 31-12-2023	Mbyllur më 31-12-2022	Mbyllur më 31-12-2021
1	Të ardhurat nga shitjet	34 593 959 157	46 100 308 238	36 494 810 448
2	Shpenzimet operative	(34 012 367 836)	(44 783 280 357)	(35 699 380 238)
3	Fitimi operativ (1+2)	581 591 321	1 317 027 881	795 430 211
4	Të ardhura/shpenzime financiare	(117 720 128)	(85 173 407)	(30 449 086)
5	Fitimi para tatimit (3+4)	463 871 193	1 231 854 475	764 981 125
6	Shpenzime të pazbritshme	4 479 791	1 037 383	1 099 314
7	Fitimi i tatueshëm (5+6)	468 350 984	1 232 891 857	766 080 438
8	Shpenzim Tatim Fitimi (7*15%)	(70 252 648)	(184 933 779)	(114 912 066)
9	Fitimi Neto (5-8)	393 618 545	1 046 920 696	650 069 059
10	Të ardhura të tjera gjithpërfshirë	0	0	0
11	Total të ardhura gjithpërfshirë	393 618 545	1 046 920 696	650 069 059

- **Fitimi para tatimit** ne vleren 463,871,193 lekë. Shoqëria ka llogaritur shpenzime te pazbritshme ne shumen 4,479,791 Leke te cilat jane penalitete, sherbime per personelin, etj.

- **Fitimi i Tatueshëm** eshte ne shumen 468,350,984 lekë dhe mbi këtë bazë është llogaritur dhe **Tatimi mbi Fitimin** ne shumen 70,252,648 lekë.

14 - Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

15- Transaksionet me palët e lidhura

Shoqëria nuk ka probleme me palet e lidhura.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

16- Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

17- Ngjarje pas datës së raportimit financiar

NUK KA

Administrator i INFO TELECOM Shpk

ADA OSMANAJ

(Ada Osmano)



Hartues i pasqyrave financiare

MIMOZA KORBECI

(Mimoza Korbeci)

ELONA MUCA

(Elona Muca)